

LEGJISLACIONI PYJOR SHQIPTAR I KRAHASUAR ME ATË TË BASHKIMIT EVROPIAN



Analiza dhe rekomandime



© 2025 PPNEA

Ky raport është prodhuar nga Organizata për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri, PPNEA, në kuadër të projektit “Forest Beyond Borders”, i financuar nga fondacioni EuroNatur.

Projekti “Forest Beyond Borders” ka si qëllim vlerësimin e gjendjes së pyjeve primare dhe të vjetër (PF/OGF) në Ballkanin Perëndimor përgjatë një periudhe prej 2.5 vitesh. Objektivat kryesore të projektit përfshijnë zhvillimin e një metode të harmonizuar të identifikimit të këtyre pyjeve në rajon, si dhe krijimin e një harte gjithëpërfshirëse. Akoma më tej, projekti synon zhvillimin e një analize të thelluar të kuadrit ligjor për mbrojtjen e pyjeve të vjetër dhe primare, si dhe implementimin e masave për të përmirësuar përpjekjet për ruajtjen e tyre.

Ky raport paraqet një analizë të kuadrit ligjor që rregullon pyjet në Shqipëri, duke shqyrtuar mangësitë dhe përputhshmërinë e tij me kuadrin ligjor të Bashkimit Evropian. Raporti thekson fushat kyçe ku kuadri kombëtar devijon nga standardet e BE-së dhe ofron rekomandime drejtuar vendimmarrësve për të siguruar mbrojtjen dhe menaxhimin efektiv të pyjeve në Shqipëri.

Legjislacioni pyjor shqiptar i krahasuar me atë të Bashkimit Evropian

Analiza dhe rekomandime

Autor:
Ing. Abdulla Diku

Dhjetor 2024

Shkurtime e përdorura në tekst

AKP	Agjencia Kombëtare e Pyjeve
BE	Bashkimi Evropian
CBD	Konventa për Diversitetin Biologjik
EEC	Komuniteti Ekonomik Evropian
EFFIS	Sistemi Evropian i Informacionit për Zjarret në Pyje
EUDR	Rregullorja e Bashkimit Evropian për Shpyllëzimin
EUTR	Rregullorja e Bashkimit Evropian për Drurin
FAO	Organizata Botërore e Ushqimit dhe Bujqësisë
FLEGT	Zbatimi i Legjislacionit Pyjor, Qeverisja dhe Tregtia
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPCC	Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike
IUCN	Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
KE	Këshilli i Evropës
LULUCF	Përdorimi i tokës, ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pylltaria
SWD	Dokumenti i punës së stafit
UNFCCC	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Përmbajtja

- 6 Gjendja e pyjeve në Shqipëri
- 7 Hyrje mbi legjislacionin pyjor shqiptar
- 8 Mënyra e analizimit të përputhshmërisë së legjislacionit kombëtar me atë të BE-së
- 9 Përputhshmëria e legjislacionit pyjor shqiptar me legjislacionin pyjor të BE-së
- 10 Përputhshmëria me rregulloren EUTR
- 14 Përputhshmëria me rregulloren FLEGT
- 19 Përputhshmëria me rregulloren LULUCF
- 20 Pyjet e vjetër në legjislacionin kombëtar dhe atë të huaj
- 24 Rregullorja 2024/1991 për restaurimin e natyrës
- 25 Rekomandime për përmirësime në legjislacionin pyjor shqiptar
- 27 **Aneksi 1 :**
Rregullore (BE) Nr. 995/2010 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e 20 tetorit 2010
- 41 **Aneksi 2:**
Rregullore e Këshillit (KE) Nr. 2173/2025 e 20 dhjetorit 2005
- 8 **Figura 1:**
Legjislacioni pyjor shqiptar ndër vite..
- 11 **Figura 2:**
Vlerësimi i përputhshmërisë së legjislacionit pyjor me rregulloren EUTR, në pikë
- 14 **Figura 3:**
Vlerësimi i përputhshmërisë së legjislacionit pyjor me rregulloren FLEGT, në pikë
- 15 **Figura 4:**
Parashtrimet ligjore lidhur me zbatimin e rregullore FLEGT, në ligjin 57/2020
- 20 **Figura 5:**
Pyjet e vjetër në legjislacionin kombëtar dhe atë të huaj
- 22 **Figura 6:**
Neni 46 i ligjit 87/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”
- 11 **Tabela 1:**
Përputhshmëria ndërmjet rregullore EUTR dhe Ligjit 57/2020
- 15 **Tabela 2:**
Përputhshmëria ndërmjet rregullore FLEGT dhe Ligjit 57/2020

Gjendja e pyjeve në Shqipëri

Sipas Dokumentit të Politikave Pyjore 2030, Shqipëria vlerësohet si “një vend i pasur me pyje të varfëra”. Aktualisht¹ fondi pyjor kombëtar përbëhet nga 1,146,725 ha me pyje, me një vëllim të përgjithshëm prej 53.18 milion m³, dhe një volum mesatar prej 48.4 m³/ha. Gjithsej, 97.5% e sipërfaqes pyjore është në pronësi shtetërore dhe vetëm 2.5% në pronësi private. Afro 20% e sipërfaqes pyjore të vendit përfshihet në rrjetin kombëtar të Zonave të Mbrojtura. Që nga viti 2016, menaxhimi dhe administrimi i pyjeve bëhet nga bashkitë (në pyjet që janë jashtë rrjetit të zonave të mbrojtura, ose 77.5% të sipërfaqes pyjore të vendit).

Pavarësisht progresit të bërë me legjislacionin pyjor, çështja e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve mbetet një problem i pazgjidhur prej dekadash në Shqipëri. Degradimi i fondit pyjor kombëtar është pikërisht një tregues i tillë. Vetëm gjatë 20 viteve të fundit, vëllimi i fondit pyjor kombëtar është zvogëluar me afro 35%², për shkak të prerjeve, zjarreve në pyje dhe informalitetit të lartë që ekziston në këtë sektor. Sipas EFFIS (Sistemi Evropian i Informacionit për Zjarret në Pyje), përgjatë periudhës 2007-2024 sipërfaqja e djegur në Shqipëri është 457,953 ha³. Vetëm në vitin 2024, sipërfaqja e djegur në Shqipëri është 46,584 ha⁴.

Nga ana tjetër, investimet e kufizuara në shkallë kombëtare me një mesatare prej vetëm 961,954⁵ euro në vit (aq sa janë nevojat për të zbatuar vetëm një plan menaxhimi për një ekonomi pyjore nga 250 të tilla që ka vendi), është një tregues i lënies totalisht pas dore të këtij sektori. Po ashtu, administrata pyjore është e pamjaftueshme si për nga numri, ashtu dhe nga cilësia. Mjafton të përmendim që aktualisht në sektorin pyjor në Shqipëri, vetëm 25% e të punësuarve aty janë specialistë pyjesh. Megjithatë të dhënat zyrtare nuk japin shifra reale të pikësimit të sipërfaqes pyjore (kjo për shkak të ndryshimeve të përkufizimit të terminologjisë “pyll”), rezultati është që Shqipëria mbetet aktualisht një vend me erozion mjaft të lartë dhe problematik. Bazuar në raportin ‘*Land Degradation Neutrality Target for Albania and Soil Erosion Measurement Norms and Standards*’ (Shallari 2019)⁶ thuhet se “*Të dhënat kërkimore shkencore tregojnë se nivelet e erozionit të tokës variojnë nga 10 në 70 ton/ha/vit dhe në raste të veçanta edhe mbi 100 ton/ha/vit që nënkupton një shkallë mesatare kombëtare të erozionit të tokës prej 27.2 ton për hektar në vit, që është më shumë se dyfishi i nivelit të erozionit “të tolerueshëm” të vendosur nga shumë vende. Kjo do të thotë gjithashtu se mesatarisht 2.3 mm tokë e sipërme (topsoil) e vlefshme humbet çdo vit*”.

Po ashtu, sipas *Global Forest Watch*, rezulton se në periudhën 2001-2023, Shqipëria ka humbur 50,100 ha me pyje⁷.

Shumica e sipërfaqeve pyjore të vendit, të shpyllëzuara nga zjarret masive dhe prerjet po zhvendosen nga faza e degradimit drejt asaj të shkretëtirizimit, pasi mungesa e fondeve për rigjenerimin e pyjeve dhe masat zbutëse ndaj erozionit mungojnë thujtë totalisht.

¹ INSTAT 2023

² INSTAT, 2024

³ <https://forest-fire.emergency.copernicus.eu/>

⁴ EFFIS 2024. <https://forest-fire.emergency.copernicus.eu/apps/effis.statistics/estimates>

⁵ INSTAT, 2024

⁶ https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/WEB_final_report.pdf

⁷ <https://www.globalforestwatch.org/>

Hyrje mbi legjislacionin pyjor shqiptar

Menaxhimi i pyjeve përpara shpalljes së pavarësisë (1912) bazohej kryesisht në praktikat kanunore (që e kanë bazën e tyre në shekullin e XV), të cilat kishin përfshirë në to edhe çështjet e përdorimit të pyjeve, të drejtat dhe pronësinë mbi to.

Legjislacioni pyjor shqiptar ka një histori më shumë se 100 vjeçare, duke u bërë kështu ndër legjislacionet më të vjetra të shtetit modern shqiptar, pas pavarësisë së tij. Një kthim në retrospektivë, na sjell në vëmendje ligjin e parë pyjor shqiptar të quajtur “Ligji i pyjeve dhe kulllosave” i 27 Janarit 1923. Ky ligj, hodhi themelet e administrimit të pyjeve dhe pylltarisë shqiptare, duke u bazuar në përvojën e vendeve të zhvilluara evropiane. Nga ana tjetër, ky ligj, përveçse ndërthurte traditën zakonore shqiptare në drejtim të menaxhimit dhe përdorimit të pyjeve, me një dimension krejt tjetër të praktikave moderne të menaxhimit dhe trajtimit të tyre. Ligji përfshinte gjithçka kishte të bënte me fondin pyjor dhe kulllosor në Shqipëri, duke përfshirë: pronësinë, të drejtën e përdorimit, mënyrat e administrimit, administratën pyjore, shfrytëzimin e qëndrueshëm të pyjeve, tregtinë e produkteve pyjore, etj. Ky është njëkohësisht edhe ligji i cili ka qenë në fuqi prej rreth 38 vitesh dhe më shumë se çdo ligj tjetër në fushën e pyjeve (1923-1961), duke shërbyer në dy sisteme të ndryshme politike: Monarkia dhe Socializmi.

Në periudhën e monizmit, dy ligje të tjera kanë operuar në fushën e pyjeve, ligji nr. 3349, datë 3.10.1961 ‘Për mbrojtjen e pyjeve’ i cili përshtati menaxhimin dhe shfrytëzimin e pyjeve nga ndërmarrjet shtetërore. Në të njëjtën linjë thuhet edhe ligji Nr.4407 datë 25.06.1968 ‘Për pyjet’, i cili ishte në fuqi deri në vitin 1992.

Ligji Nr. 7623 datë 13. 10. 1992 “Për pyjet dhe policinë e shërbimit pyjor” ishte ligji i parë për pyjet në vitet post-monizëm. Një ligj po ashtu shumë i plotë dhe gjithëpërfshirës sa i përket të drejtave të përdorimit, menaxhimit të pyjeve shtetërore, administratës pyjore, etj. Ky ligj përfshinte tre koncepte të pyjeve; pyjet shtetërore, komunale dhe private. Në ligj, përfshihej edhe menaxhimi dhe administrimi i kullotave.

Ligji nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i dha një dimension tjetër sektorit pyjor në Shqipëri, duke përshtatur praktikat dhe situatat në të cilat ndodhej vendi.

Duhet theksuar se asnjë nga ligjet e mësipërme, nuk përfshinte në të elementë të përputhshmërisë apo përafritimit me legjislacionin pyjor të BE-së.

Ligji 7/2020 “Për pyjet”, është ligji i parë pyjor shqiptar i cili shkruan në të se është i përafëruar pjesërisht me legjislacionin evropian në fushën e pyjeve, dhe konkretisht:

- *Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 2173/2005, datë 20 dhjetor 2005 “Mbi ngritjen e një skeme licensimi FLEGT për importin e lëndës drusore në Komunitetin Evropian”, të ndryshuar.*
- *Rregulloren (BE) nr. 995/2010 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 20 tetor 2010 “Mbi përcaktimin e detyrimeve të operatorëve, të cilët vendosin në treg lëndë drusore dhe produkte të lëndëve drusore”, të ndryshuar.*
- *Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) nr 607/2012, datë 6 korrik 2012 “Mbi rregullat e hollësishme në lidhje me sistemin e kujdesit të duhur dhe shpeshësinë dhe natyrën e kontroleve mbi organizatat monitoruese”.*

Nga ana tjetër, praktikat e deritanishme kanë treguar se, pavarësisht se në një ligj apo akt tjetër ligjor shkruhet se ai është i përafëruar (pjesërisht apo plotësisht) me direktivat apo rregulloret e BE-së, kjo nuk ka rezultuar e saktë. Ndaj, në këtë dokument, do të shohim se sa dhe si legjislacioni aktual pyjor në Shqipëri është i përafëruar me atë të BE-së.

Mënyra e analizimit të përputhshmërisë së legjislacionit kombëtar me atë të BE-së

Janë dy mënyra për të parë nivelin e përafritimit apo përputhshmërisë së legjislacionit me atë të BE-së:

1. Vlerësimi përgatitor paraprak (*Sreen preparatory assessment*), i cili është një instrument formal dhe teknik që bëhet nga Komisioni Evropian për të përgatitur negociatat e anëtarësimit me vendet candidate. *Sreening* u mundëson vendeve candidate të familjarizohen me *acquis* dhe detyrimet që ato paraqesin (pasi edhe vendi kandidat duhet të jetë në gjendje të zbatojë *acquis*), dhe për këtë arsye kontribuon në përgatitjet e tyre për anëtarësim. Ky është më shumë një ‘ushtrim’ që vendet candidate e bëjnë gjatë hapjes së negociatave, për të treguar të kuptuarit dhe nivelin e përafritimit të legjislacionit të tyre me atë të BE-së.
2. Analiza e shkallës së përputhshmërisë ndërmjet legjislacionit kombëtar dhe disa direktivave të përzgjedhura të BE-së dhe/ose rregullore përmes të ashtuquajturave ‘Tabela të përputhshmërisë’ (*Tables of concordances*). Vlerësimi sipas tabelave të përputhshmërisë, shoqërohet edhe me një shpjegim përkatës me tekst, për çdo akt ligjor të analizuar dhe të përfshirë në vlerësim.

Vlerësimi ynë në këtë dokument, do të bazohet pikërisht në opsionin e dytë: duke vendosur legjislacionin kombëtar pyjor përballë atij të BE-së, përmes përdorimit të Tabelave të përputhshmërisë. Në këtë rast, tabelës së përputhshmërisë i është hequr kolona ‘Kur është planifikuar transpozimi i plotë’ pasi nuk është qëllim i këtij dokumenti (transpozimi i plotë varet nga qeveria shqiptare). Nga ana tjetër, tabelës i është shtuar një kolonë me përshkrimin ‘Shënime’ në të cilën janë vendosur komente të ndryshme që dalin gjatë fazës së analizimit të legjislacionit. Për çdo element të rregullores përkatëse të BE-së, kur përputhshmëria e legjislacionit kombëtar ka qenë maksimale është bërë vlerësimi me pikët maksimale (vlerësimi maksimal 5) dhe në rastet kur nuk ka patur përputhshmëri, vlerësimi është bërë me 0. Në disa raste kur ka patur një përputhshmëri të pjesshme është bërë vlerësimi i ndërmjetëm (nga 1-5).

Në këtë dokument, tabelat e përputhshmërisë janë paraqitur në formë aneksesh, ndërsa këtu jepet përmbledhja dhe gjetjet e vlerësimit të bërë.

Nga procesi i vlerësimit janë përjashtuar rastet kur rregulloret e BE-së kanë të bëjnë me vetë vendet anëtare. Në këtë rast është bërë shënimi në kolonën përkatëse ‘*Të mos vlerësohet*’.




Figura 1.
Legjislacioni pyjor shqiptar ndër vite

Përputhshmëria e legjislacionit pyjor shqiptar me legjislacionin pyjor të BE-së

Dy rregulloret bazë të BE-së lidhur me menaxhimin e pyjeve, mbrojtjen e tyre dhe tregtimin e produkteve pyjore janë:

- Rregullorja Nr. 995/2010⁸ e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 tetor 2010, që njihet si rregullorja EUTR. Kjo rregullore, është pjesë e politikës së Bashkimit Evropian për të luftuar prerjet e paligjshme dhe tregtinë e produkteve drusore. Ajo ndalon vendosjen në tregun e BE-së të lëndës drusore të prerë ilegalisht ose produkteve të drurit që rrjedhin nga druri i tillë.
- Rregullorja Nr 2173/2005 e datës 20 dhjetor 2005 mbi themelimin e një skeme licensimi FLEGT për importet e drurit në Komunitetin Evropian. Kjo rregullore përcakton një grup rregullash komunitare për importin e produkteve të caktuara të drurit për qëllime të zbatimit të skemës së licensimit FLEGT. Skema e licensimit zbatohet nëpërmjet Marrëveshjeve të Partneritetit me vendet prodhuese të lëndës drusore.

Nga ana tjetër, ligji 57/2020 'Për pyjet' është ligji bazë mbi të cilën është bërë analiza përkatëse, si dhe aktet nën-ligjore të derivuara prej tij deri më sot.

Duhet thënë që në fillim se rregulloret e BE-së (EUTR dhe FLEGT) e vënë theksin e tyre tek shfrytëzimi i qëndrueshëm i produkteve pyjore e jo-pyjore. Përveç kësaj, përmes rregulloreve të mësipërme, BE ka vënë rregulla strikte lidhur me importin e produkteve drusore nga vendet jashtë komunitetit, kanë ngritur sisteme dhe skema licensimi për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit pyjor dhe mbi të gjitha kanë ngritur struktura operuese dhe monitoruese për zbatimin e legjislacionit.

Teksa bëjmë krahasimin e legjislacionit pyjor shqiptar me rregulloret përkatëse të BE-së, nuk është e thënë që të ketë një përputhje në gjithçka që shkruhet në legjislacionin tonë. Kjo pasi legjislacioni kombëtar nuk përmban vetëm elementët e dy rregulloreve EUTR dhe FLEGT, por përmban edhe elementë të tjerë të karakterit menaxhues, administrues dhe të zbatimit të ligjshmërisë.

Do të ishte mirë nëse përputhshmëria në këtë rast të ishte maksimale, por teksa kuadri ligjor pyjor është plotësuar thuajse me të gjitha aktet nën-ligjore, kanë mbetur pa u përgatitur dhe miratuar aktet që lidhen me rregulloret bazë të BE-së; EUTR dhe FLEGT. Vetëm pasi të hartohen këto akte, atëherë mund të thuhet se legjislacioni pyjor shqiptar është i përputhur me atë të BE-së.

Siç është theksuar më sipër, mënyra e analizimit të legjislacionit është përmes tabelave të përputhshmërisë, dhe baza kryesore e përputhshmërisë është si vijon:

8 Kjo rregullore në vijim do të quhet rregullorja EUDR dhe do të hyjë në fuqi më 30 dhjetor 2025. Kjo rregullore zbatohet për kompanitë që vendosin mallra ose produkte përkatëse në tregun e BE-së, ose i eksportojnë ato prej tij. Ata do të duhet të tregojnë se produktet e tyre janë pa shkaktuar shpyllëzim dhe nuk lidhen me degradimin e pyjeve, as me shfrytëzim dhe tregti të paligjshme.

Përputhshmëria me rregulloren EUTR

Përputhshmëria me rregulloren EUTR, Nr. 995/2010 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 tetor 2010.

Kjo rregullore është vlerësuar në total në 26 elementë të saj përkundrejt legjislacionit kombëtar në fushën e pyjeve në Shqipëri. Në total, nëse përputhshmëria do të ishte e plotë, vlerësimi në tabelën përkatëse do të ishte me 130 pikë ($26 \times 5 = 130$). Nuk janë përfshirë në vlerësim 25 elementë të kësaj rregullorje, të cilat lidhen me vendet anëtare të BE-së. Nga vlerësimi i detajuar i bërë, rezulton se nga 26 elementët e vlerësuar të rregullores EUTR, vlerësimi i përgjithshëm është me numrin e 18 elementëve, pasi gjashtë elementët e pavlerësuar lidhen me të qenit vend anëtar i BE-së. Vetëm në dy elementë ka patur përputhshmëri të plotë me legjislacionin kombëtar, konkretisht me nenet 2 dhe 3 të rregullores. Përputhshmëria në rastin e nenit 2 të rregullores është vlerësuar se qëndron e plotë (5 pikë) pasi ka të bëjë me përkufizime: si në rastin e vetë rregullores ashtu dhe atë të ligjit 57/2020. Në këtë rast, në ligjin 57/2020, neni 3.11 përkufizimi është: *“Druri dhe produktet e drurit” janë lënda drusore dhe produktet e drurit, të përcaktuara në kodin përkatës doganor dhe/ose në nomenklaturën e kombinuar të mallrave, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave sipas dispozitave të ligjit nr. 9461, datë 21.12.2005, “Për nomenklaturën e mallrave dhe tarifën e integruar doganore”, të ndryshuar, me përjashtim të produkteve të drurit apo komponentëve të këtyre produkteve, të prodhuara nga drurët ose produktet e tyre, të cilat kanë përfunduar ciklin e jetës së tyre dhe në rast të kundërt do të asgjësoheshin si mbetje në kuptimin e pikës 31 të nenit 3 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar.*

Në rastin e nenit 3 të rregullores EUTR, përputhshmëria konsiderohet e plotë pasi në ligjin 57/2020, neni 28 pika 2 thuhet; *“Pranohen si të ligjshme druri dhe produktet e drurit, të shoqëruara me licensë sipas FLEGT-it ose Konventës për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara (CITES)”*.

Vlerësim me tre pikë ka patur në rastin e nenit 5 të rregullores, ku përafrimi me legjislacionin tonë është relativisht i mirë. Bëhet fjalë për nenin 27.7 të ligjit 57/2020, i cili thotë: *‘Materiali drusor i papërpunuar, si dhe prodhimet e tjera pyjore e jopyjore transportohen nga pikat e grumbullimit dhe qendrat e përpunimit deri në destinacionin përfundimtar, të shoqëruara me vërtetim transporti, të lëshuar nga struktura përkatëse e shërbimit pyjor në bashki ose nga pronari privat që vërteton se prodhimi është në përputhje me ligjin. Modeli i vërtetimit të transportit miratohet me urdhër të ministrit’*. Nuk është vlerësuar me 5 pikë këtu, pasi në legjislacionin kombëtar nuk parashikohet koha e ruajtjes së dokumentacionit për periudhën 5 vjeçare, siç shkruhet në rregullore.

Në tre raste të tjera është vlerësuar përputhje e pjesshme dhe në këto raste vlerësimi i përputhshmërisë është bërë me nga 1 deri 4 pikë.

Vlerësimi përkatës jepet në figurën nr. 2.




Figura 2. Vlerësimi i përputhshmërisë së legjislacionit pyjor me rregulloren EUTR, në pikë.

Nga figura 2 vërehet se niveli i përputhshmërisë në këtë fazë është rreth 14%. Praktikisht shumë i ulët si nivel përputhshmërie, një tregues ky se sa e madhe është hapsira ndërmjet dy legjislacioneve respektive.

Përmbledhja e vlerësimit për rregulloren EUTR jepet në tabelën 1 në vijim:

TABELA 1 Përputhshmëria ndërmjet rregullores EUTR dhe Ligjit 57/2020

Rregullorja EUTR		Ligji 57/2020		Vlerësimi i përputhshmërisë, në pikë
Neni	Përshkrimi	Neni	Përshkrimi	
2	Për qëllimet e kësaj rregulloreje, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme: “Dru dhe produkte druri” do të thotë druri dhe produktet e drurit të përcaktuara në Aneks, me përjashtim të produkteve të drurit ose përbërësve të këtyre produkteve të prodhuara nga druri ose produkte druri që kanë përfunduar ciklin e tyre jetësor dhe përndryshe do të hidheshin si mbetje, si përcaktuar në nenin 3(1) të Direktivës 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 19 nëntor 2008 mbi mbetjet.	3.11	“Druri dhe produktet e drurit” janë lënda drusore dhe produktet e drurit, të përcaktuara në kodin përkatës doganor dhe/ose në nomenklaturën e kombinuar të mallrave, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave sipas dispozitave të ligjit nr. 9461, datë 21.12.2005, “Për nomenklaturën e mallrave dhe tarifën e integruar doganore”, të ndryshuar, me përjashtim të produkteve të drurit apo komponentëve të këtyre produkteve, të prodhuara nga drurët ose produktet e tyre, të cilat kanë përfunduar ciklin e jetës së tyre dhe në rast të kundërt do të asgjësoheshin si mbetje në kuptimin e pikës 31 të nenit 3 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar.	5

Rregullorja EUTR		Ligji 57/2020		Vlerësimi i përputhshmërisë, në pikë
Neni	Përshkrimi	Neni	Përshkrimi	
3	<p>Statusi i drurit dhe produkteve të drurit të mbuluar nga FLEGT dhe CITES.</p> <p>Lënda e vendosur në produktet e drurit të listuara në anekset II dhe III të Rregullores (EC) Nr. 2173/2005, e cila është me origjinë nga vendet partnere të listuara në aneksin I të asaj rregulloreje dhe që përputhet me atë rregullore dhe dispozitat e saj zbatuese, do të konsiderohet se është shfrytëzuar ligjërisht për qëllimet e kësaj rregulloreje.</p> <p>Lënda e specieve të listuara në Aneksin A, B ose C të Rregullores (EC) Nr 338/97 dhe që është në përputhje me atë rregullore dhe dispozitat e saj zbatuese do të konsiderohet se është shfrytëzuar ligjërisht për qëllimet e kësaj rregulloreje.</p>	28.2	Pranohen si të ligjshme, druri dhe produktet e drurit, të shoqëruara me licensë sipas FLEGT-it ose Konventës për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara (CITES).	5
4	<p>Detyrimet e operatorëve:</p> <p>1. Ndalohet vendosja në treg e lëndës drusore të prerë ilegalisht ose e produkteve të drurit të përfutuara prej saj.</p> <p>2. Operatorët duhet të ushtrojnë kujdesin e duhur kur vendosin lëndë druri ose produkte druri në treg. Për këtë qëllim, ata do të përdorin një kornizë procedurash dhe masash, në vijim të referuar si “sistem i kujdesit të duhur”, siç përcaktohet në nenin 6.</p> <p>3. Çdo operator do të mbajë dhe vlerësojë rregullisht sistemin e kujdesit të duhur që përdor, përveç rasteve kur operatori përdor një sistem të kujdesit të duhur të krijuar nga një organizatë monitoruese e përmendur në nenin 8. Sistemet ekzistuese të mbikëqyrjes sipas legjislacionit kombëtar dhe çdo zinxhiri vullnetar të të mekanizmit të kujdestarisë, që përmbush kërkesat e kësaj rregulloreje mund të përdoret si bazë për sistemin e kujdesit të duhur.</p>	28.1	Subjektet që veprojnë në tregtinë e lëndës drusore duhet të ushtrojnë “kujdesin e duhur” kur ato fusin në tregun e BE-së drurin ose produktet e drurit, vendas ose të importuar.	1

Rregullorja EUTR		Ligji 57/2020		Vlerësimi i përputhshmërisë, në pikë
Neni	Përshkrimi	Neni	Përshkrimi	
5	<p>Detyrimi i gjurmueshmërisë</p> <p>Tregtarët, përgjatë zinxhirit të furnizimit, do të jenë në gjendje të identifikojnë:</p> <p>a. operatorët ose tregtarët që kanë furnizuar me lëndë druri dhe produkte druri; dhe</p> <p>b. sipas rastit, tregtarët të cilëve u kanë furnizuar lëndë druri dhe produkte druri.</p> <p>Tregtarët do të ruajnë informacionin e përmendur në paragrafin e parë për të paktën pesë vjet dhe do t'ia japin atë informacion autoriteteve kompetente nëse ato kërkojnë.</p>	27.7	<p>Materiali drusor i papërpunuar, si dhe prodhimet e tjera pyjore e jopyjore transportohen nga pikat e grumbullimit dhe qendrat e përpunimit deri në destinacionin përfundimtar, të shoqëruara me vërtetim transporti, të lëshuar nga struktura përkatëse e shërbimit pyjor në bashki ose nga pronari privat që vërteton se prodhimi është në përputhje me ligjin. Modeli i vërtetimit të transportit miratohet me urdhër të ministrit.</p>	3
6	<p>Sistemet e kujdesit të duhur</p> <p>1. Sistemi i kujdesit të duhur të përmendur në nenin 4(2) do të përmbajë elementët e mëposhtëm:</p> <p>— masat dhe procedurat që ofrojnë akses në informacionin e mëposhtëm në lidhje me furnizimin e operatorit me lëndë druri ose produkte druri të vendosura në treg,</p> <p>— përshkrimin, duke përfshirë emrin tregtar dhe llojin e produktit, si dhe emrin e përbashkët të specieve të drurëve dhe, sipas rastit, emrin e tij të plotë shkencor,</p> <p>— vendi i shfrytëzimit dhe aty ku është e aplikueshme:</p> <p>(i rajoni nënkombëtar ku është shfrytëzuar druri; dhe</p> <p>(ii) koncesioni i shfrytëzimit,</p> <p>— sasia (e shprehur në vëllim, peshë ose numër njësisish),</p> <p>— emri dhe adresa e furnizuesit për operatorin,</p> <p>— emrin dhe adresën e tregtarit të cilit i janë furnizuar lëndët drusore dhe produktet e drurit,</p> <p>— dokumente ose informacione të tjera që tregojnë përputhshmërinë e këtyre lëndëve drusore dhe produkteve të drurit me legjislacionin në fuqi;</p>	<p>3.25</p> <p>27.8</p>	<p>“Kujdesi i duhur” është sistemi i kujdesit të nevojshëm për parandalimin e tregtimit të paligjshëm të drurit dhe prodhimeve që rrjedhin prej tij.</p> <p>Subjektet që veprojnë në tregtinë e lëndës drusore dhe të prodhimeve jodrusore pyjore zbatojnë sistemin “kujdesi i duhur” për të parandaluar tregtimin e tyre nëse janë prerë apo grumbulluar në mënyrë të paligjshme. Për zbatimin e sistemit “kujdesi i duhur”:</p> <p>a) shitësi dhe blerësi i lëndës drusore, të papërpunuar e të përpunuar, dhe i prodhimeve jodrusore pyjore janë të detyruar të vërtetojnë origjinën e ligjshme të tyre nëpërmjet kontratave dhe dokumentacionit tjetër plotësues ligjor, përfshirë detyrimisht certifikatën e origjinës;</p> <p>b) rregullat dhe procedurat për zbatimin e sistemit “kujdesi i duhur” miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.</p>	4
Totali				18

Vlerësimi i detajuar, bazuar në tabelat e përputhshmërisë, jepet në Aneksin 1 të këtij raporti.

Përputhshmëria me rregulloren FLEGT

Përputhshmëria me rregulloren FLEGT, nr. 2173/2005 e datës 20 dhjetor 2005 mbi themelimin e një skeme licensimi FLEGT për importet e drurit në Komunitetin Evropian. Procedura e vlerësimit të përputhshmërisë edhe në këtë rast ka qenë e njëjtë. Lidhur me këtë rregullore, janë vlerësuar gjithsej 22 elementë, ku vlerësimi në rast të përputhshmërisë së plotë do të ishte me 110 pikë (22x5). Nuk janë përfshirë në vlerësim 16 elementë, të cilët lidhen me vendet anëtare të BE-së. Nga vlerësimi i bërë, rezulton se legjislacioni pyjor shqiptar në këtë rast ka një përputhshmëri prej 29 pikësh. Pikët maksimale të përputhshmërisë (5) kanë qenë në rastet e përkufizimeve si psh. në rastin e nenit 2.6 të rregullores e cila është vlerësuar si e përputhur me nenin 27.8 në të cilin thuhet se ‘Subjektet që veprojnë në tregtinë e lëndës drusore dhe të prodhimeve jodrusore pyjore zbatojnë sistemin “kujdesi i duhur” për të parandaluar tregtimin e tyre nëse janë prerë apo grumbulluar në mënyrë të paligjshme...’. Përputhshmëri e plotë është vlerësuar edhe në rastin e nenit 2.9 të rregullores me nenin 3.11 të ligjit 57/2020 i cili thotë: “Druri dhe produktet e drurit” janë lënda drusore dhe produktet e drurit, të përcaktuara në kodin përkatës doganor dhe/ose në nomenklaturën e kombinuar të mallrave, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave sipas dispozitave të ligjit nr. 9461, datë 21.12.2005, “Për nomenklaturën e mallrave dhe tarifën e integruar doganore”, të ndryshuar, me përjashtim të produkteve të drurit apo komponentëve të këtyre produkteve, të prodhuara nga drurët ose produktet e tyre, të cilat kanë përfunduar ciklin e jetës së tyre dhe në rast të kundërt do të asgjësoheshin si mbetje në kuptimin e pikës 31 të nenit 3 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar. Edhe neni 4.3 i rregullores FLEGT vlerësohet i përputhur plotësisht me nenin 28.2 të ligjit 57/2020 i cili ka këtë përmbajtje; ‘Pranohen si të ligjshme druri dhe produktet e drurit, të shoqëruara me licensë sipas FLEGT-it ose Konventës për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara (CITES)’. Në raste të tjera përputhshmëria ka qenë e pjesshme dhe është vlerësuar me pikët përkatëse, ose në rastin kur nuk ka patur përputhshmëri, është bërë vlerësimi me zero pikë.

Grafiku 3 në vijim jep vlerësimin e bërë në këtë rast.




Figura 3. Vlerësimi i përputhshmërisë së legjislacionit pyjor me rregulloren FLEGT, në pikë.



Në këtë rast, niveli i përputhshmërisë vlerësohet në 26%, i cili është gjithashtu shumë i ulët. Siç shihet, duket se legjislacioni pyjor shqiptar është paksa më shumë i përputhur me rregulloren FLEGT. Kjo pasi në ligjin bazë për pyjet (57/2020) ka më shumë elementë të kësaj rregulloreje se sa EUTR, siç jepet në figurën në vijim:

Neni 28	
Shitja e lëndës së drurit dhe produkteve të tij në tregun e BE-së	
1. Subjektet që veprojnë në tregtinë e lëndës drusore duhet të ushtrojnë “kujdesin e duhur” kur ato fusin në tregun e BE-së drurin ose produktet e drurit, vendas ose të importuar.	
2. Pranohen si të ligjshme druri dhe produktet e drurit, të shoqëruara me licencë sipas FLEGT-it ose Konventës për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara (CITES).	
3. Skema e licencimit FLEGT përbën një grupim rregullash dhe procedurash për importin e disa produkteve të drurit, që zbatohet nëpërmjet marrëveshjeve të partneritetit me shtetet që prodhojnë dru/lëndë druri.	
4. Me propozimin e ministrit, Këshilli i Ministrave përcakton institucionet dhe autoritetet përkatëse, si dhe miraton rregullat dhe procedurat për zbatimin e rregulloreve FLEGT dhe EUTR, përfshi zbatimin e çdo rregullimi tjetër që bëhet i detyrueshëm për shtetin shqiptar në të ardhmen.	

Figura 4

Parashtrimet ligjore lidhur me zbatimin e rregulloreve FLEGT, në ligjin 57/2020.

Nga ana tjetër, rregullorja EUTR shkruhet në vetëm dy raste dhe nuk ka përshkrime në nene të veçanta se si do të operohet me zbatimin e saj. Përjashtim bën neni 28.4 në të cilin thuhet se: *‘Me propozimin e ministrit, Këshilli i Ministrave përcakton institucionet dhe autoritetet përkatëse, si dhe miraton rregullat dhe procedurat për zbatimin e rregulloreve FLEGT dhe EUTR, përfshi zbatimin e çdo rregullimi tjetër që bëhet i detyrueshëm për shtetin shqiptar në të ardhmen.’*

Përmbledhja e vlerësimit për rregulloren FLEGT jepet në tabelën 1 në vijim:

TABELA 2 Përputhshmëria ndërmjet rregulloreve FLEGT dhe Ligjit 57/2020

Rregullorja FLEGT		Ligji 57/2020		Vlerësimi i përputhshmërisë, në pikë
Neni	Përshkrimi	Neni	Përshkrimi	
2	Përkufizimet: 1. ‘Skema e licensimit për zbatimin e ligjit pyjor, qeverisjen dhe tregtinë’ (më tej referuar si skema e licensimit FLEGT) nënkupton dhënien e licensave për produktet e drurit për eksport në Komunitet nga vendet partnere dhe zbatimin e saj në Komunitet, veçanërisht në dispozitat e Komunitetit. mbi kontrollet kufitare;	3.17	“FLEGT” është plani i veprimit i BE-së, që synon të zvogëlojë prerjet ilegale duke forcuar menaxhimin e qëndrueshëm dhe ligjor të pyjeve, duke përmirësuar qeverisjen dhe duke promovuar tregtinë e drurit të prodhuar ligjërisht.	1

Rregullorja FLEGT		Ligji 57/2020		Vlerësimi i përputhshmërisë, në pikë
Neni	Përshkrimi	Neni	Përshkrimi	
2.6	“Pjesëmarrës në treg” nënkupton një aktor, privat ose publik, i përfshirë në pylltari ose transformim ose tregtim të produkteve të drurit;	27.6	Shfrytëzimi i prodhimit drusor mund të kryhet nga persona fizik e juridik, të pajisur me leje sipas legjislacionit në fuqi për licencat, lejet dhe autorizimet, kategoria III.4, individët apo njësitë/ekipet e specializuara të bashkisë, pasi të jetë hartuar dhe miratuar projekti teknologjik i shfrytëzimit në përputhje me planin e mbarështimit. Subjektet që zotërojnë të drejtën e shfrytëzimit të prodhimeve drusore janë përgjegjëse për trajnimin dhe udhëzimin e stafit, për teknikat dhe metodologjitë e shfrytëzimit të materialit drusor, që garantojnë ruajtjen dhe ripërtëritjen e pyllit, në përputhje me kërkesat ligjore.	5
		27.7	Materiali drusor i papërpunuar, si dhe prodhimet e tjera pyjore e jopyjore transportohen nga pikat e grumbullimit dhe qendrat e përpunimit deri në destinacionin përfundimtar, të shoqëruara me vërtetim transporti, të lëshuar nga struktura përkatëse e shërbimit pyjor në bashki ose nga pronari privat që vërteton se prodhimi është në përputhje me ligjin. Modeli i vërtetimit të transportit miratohet me urdhër të ministrit.	
2.7	“Autoriteti(et) licensues” nënkupton autoritetin(et) e caktuar nga një vend partner për të lëshuar dhe vërtetuar licencat FLEGT;	28.3	Skema e licensimit FLEGT përbën një grupim rregullash dhe procedurash për importin e disa produkteve të drurit, që zbatohet nëpërmjet marrëveshjeve të partneritetit me shtetet që prodhojnë dru/lëndë druri.	2
2.8	“autoritet(et) kompetente” nënkupton autoritetin(et) e caktuar nga Shtetet Anëtare për të verifikuar licencat FLEGT;	28.4	Me propozimin e ministrit, Këshilli i Ministrave përcakton institucionet dhe autoritetet përkatëse, si dhe miraton rregullat dhe procedurat për zbatimin e rregulloreve FLEGT dhe EUTR, përfshi zbatimin e çdo rregullimi tjetër që bëhet i detyrueshëm për shtetin shqiptar në të ardhmen.	2

Rregullorja FLEGT		Ligji 57/2020		Vlerësimi i përputhshmërisë, në pikë
Neni	Përshkrimi	Neni	Përshkrimi	
2.9	“Produkte druri” do të thotë produktet e përcaktuara në anekset II dhe III, për të cilat zbatohet skema e licensimit FLEGT, dhe të cilat, kur importohen në Komunitet, nuk mund të cilësohen si “mallra të një natyre jokomerciale” siç përcaktohet në pikën 6 të nenit 1 të Rregullores së Komisionit (EEC) Nr 2454/93 e datës 2 korrik 1993 që përcakton dispozitat për zbatimin e Rregullores së Këshillit (EEC) Nr. 2913/92 që përcakton Kodin Doganor të Komunitetit.	3.11	“Druri dhe produktet e drurit” janë lënda drusore dhe produktet e drurit, të përcaktuara në kodin përkatës doganor dhe/ose në nomenklaturën e kombinuar të mallrave, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave sipas dispozitave të ligjit nr. 9461, datë 21.12.2005, “Për nomenklaturën e mallrave dhe tarifën e integruar doganore”, të ndryshuar, me përjashtim të produkteve të drurit apo komponentëve të këtyre produkteve, të prodhuara nga drurët ose produktet e tyre, të cilat kanë përfunduar ciklin e jetës së tyre dhe në rast të kundërt do të asgjësoheshin si mbetje në kuptimin e pikës 31 të nenit 3 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar.	5
2.12	“Dërgesë” nënkupton një dërgesë të produkteve të drurit;	27.7	Materiali drusor i papërpunuar, si dhe prodhimet e tjera pyjore e jopyjore transportohen nga pikat e grumbullimit dhe qendrat e përpunimit deri në destinacionin përfundimtar, të shoqëruara me vërtetim transporti, të lëshuar nga struktura përkatëse e shërbimit pyjor në bashki ose nga pronari privat që vërteton se prodhimi është në përputhje me ligjin. Modeli i vërtetimit të transportit miratohet me urdhër të ministrit.	3
3.13	“Eksport” nënkupton largimin fizik ose nxjerrjen e produkteve të drurit nga çdo pjesë e territorit gjeografik të një vendi partner për t'i sjellë ato në Komunitet;	27.4	Rregullat për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin (rastet e lejuara), importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor dhe të prodhimeve jodrusore pyjore, si dhe kategorizimi i rrugëve autopyjore, përdorimi dhe standardet teknike të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.	2
3.1	Skema e licensimit FLEGT do të zbatohet vetëm për importet nga vendet partnere	28.3	Skema e licensimit FLEGT përbën një grupim rregullash dhe procedurash për importin e disa produkteve të drurit, që zbatohet nëpërmjet marrëveshjeve të partneritetit me shtetet që prodhojnë dru/lëndë druri.	2

Rregullorja FLEGT		Ligji 57/2020		Vlerësimi i përputhshmërisë, në pikë
Neni	Përshkrimi	Neni	Përshkrimi	
4.2	Skemat ekzistuese që garantojnë ligjshmërinë dhe gjurmimin e besueshëm të produkteve të drurit të eksportuara nga vendet partnere mund të përbëjnë bazën e një license FLEGT me kusht që ato skema të jenë vlerësuar dhe miratuar në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 11(2), me qëllim për të ofruar sigurinë e nevojshme në lidhje me ligjshmërinë e produkteve të drurit në fjalë.	28.2 28.4	Skema e licensimit FLEGT përbën një grupim rregullash dhe procedurash për importin e disa produkteve të drurit, që zbatohet nëpërmjet marrëveshjeve të partneritetit me shtetet që prodhojnë dru/lëndë druri. Me propozimin e ministrit, Këshilli i Ministrave përcakton institucionet dhe autoritetet përkatëse, si dhe miraton rregullat dhe procedurat për zbatimin e rregulloreve FLEGT dhe EUTR, përfshi zbatimin e çdo rregullimi tjetër që bëhet i detyrueshëm për shtetin shqiptar në të ardhmen.	1
4.3	Produktet e drurit të specieve të listuara në anekset A, B dhe C të Rregullores së Këshillit (EC) Nr 338/97 të datës 9 dhjetor 1996 mbi mbrojtjen e specieve të faunës dhe florës së egër duke rregulluar tregtinë në to, përjashtohen nga kërkesa e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni. Komisioni do ta shqyrtojë këtë përjashtim, në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 11(3), deri më 30 dhjetor 2010.	28.2	Pranohen si të ligjshme druri dhe produktet e drurit, të shoqëruara me licensë sipas FLEGT-it ose Konventës për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara (CITES).	5
Aneksi II	Produktet e drurit për të cilat zbatohet skema e licensimit FLEGT pavarësisht nga vendi partner Përshkrimi: 4403 Dru i përafërt, nëse është ose jo i zhveshur nga lëvore ose sap dru, ose përafërsisht katror; 4406 Traversa hekurudhore ose tramvaj (të kryqëzuara) prej druri; 4407 Dru i sharruar ose i copëtuar për së gjati, i prerë ose i qëruar, nëse është apo jo i rrafshuar, i lëmuar me rërë ose i lidhur në fund, me një trashësi më të madhe se 6 mm; 4408 Fletët për rimeso (përfshirë ato të marra nga prerja e drurit të laminuar), për kompensatë ose për dru të tjerë të ngjashëm të petëzuar dhe dru të tjerë, të sharruar për së gjati, të prera ose të qëruara, të rrahura ose jo, të rrahura me rërë, të bashkuara ose të lidhura në fund, me një trashësi jo mbi 6 mm; 4412 Kompensatë, panele me rimeso dhe dru të ngjashëm të laminuar.	VKM 559 dt. 29.7. 2022 Shtojca 3	Pranohen si të ligjshme druri dhe produktet e drurit, të shoqëruara me licensë sipas FLEGT-it ose Konventës për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara (CITES).	1
Totali				29

Përputhshmëria me rregulloren LULUCF

Kjo rregullore ndërlidhet me shumë sektorë të tjerë, ndër to edhe me pyjet. Bëhet fjalë për rregulloren (EU) 2018/841 të Parlamentit dhe Këshillit të Evropës e datës 30 maj 2018 për përfshirjen e emetimeve dhe largimeve të gazeve serrë nga përdorimi i tokës, ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pyjet në kuadrin e klimës dhe energjisë 2030, dhe ndryshimin e Rregullores (BE) Nr. 525/2013 dhe Vendimi Nr. 529/2013/BE. Kjo rregullore përcakton angazhimet e Shteteve Anëtare të BE-së për sektorin e përdorimit të tokës, ndryshimit të përdorimit të tokës dhe pyjeve (LULUCF) që kontribuojnë në arritjen e objektivave të Marrëveshjes së Parisit dhe përmbushjen e objektivit të reduktimit të emetimeve të gazeve serrë të BE-së për periudhën nga 2021 deri në 2030. Duke qenë se kjo është një rregullore më komplekse, vetëm disa elementë të saj janë analizuar dhe më tej janë dhënë rekomandimet përkatëse që legjislacioni pyjor në Shqipëri duhet ti marrë në konsideratë për ti përshtatur dhe përafruar. Kjo rregullore paraqet edhe një rëndësi tjetër për Shqipërinë pasi jemi pjesë e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike dhe si të tillë, sektori LULUCF është pjesë e inventarit të gazeve serrë. Kjo rregullore lidhet gjithashtu me pyjet prej faktit që në të dy rastet ato janë edhe zbutëse të efekteve të ndryshimeve klimatike, por përmes tyre përdoren edhe masa përshtatëse ndaj tyre. Ndërkohë pyjet si sektor janë përthithëse të gazeve serrë dhe si të tilla ofrojnë një shërbim të madh në ekosistem.

Në vijim jepet edhe një vlerësim për përputhshmërinë e rregullores (EU) 2018/841 Të Parlamentit dhe Këshillit të Evropës e datës 30 maj 2018 për përfshirjen e emetimeve dhe largimeve të gazeve serrë nga përdorimi i tokës, ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pyjet në kuadrin e klimës dhe energjisë 2030 (rregullorja LULUCF).

- Ligji i pyjeve 57/2020 ka disa elementë që janë pjesë e kësaj rregulloreje. Të tilla janë psh. përkufizimi që jepet në nenin 3.6 të rregullores për 'sipërfaqen pyjore'. Ky përkufizim është thujse i njëjtë me atë që gjendet në nenin 3.48 të ligjit 57/2020.
- Në rregullore ka disa terma teknike dhe përshkrime të tyre që jepen aty dhe që duhet të përshtaten nga legjislacioni pyjor shqiptar. Të tilla janë; *Përthithje, Burim, Pishinë karboni, Stoku i karbonit, Nivelit i referencës së pyjeve, Vlera e gjysmës së jetës, Shqetësimet natyrore, Oksidimi i menjëhershëm, Produkte druri të shfrytëzuara etj.* Këto përshkrime jepen në nenin 3 të rregullores në fjalë.

Shqipëria si nënshkruese e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) zbaton pjesë të kesaj rregulloreje lidhur me Komunikimet Kombëtare që ajo përgatit dhe dorëzon pranë Konventës; inventarin e gazeve serrë, masat zbutëse dhe përshtatëse ndaj ndryshimeve klimatike. Për këtë qëllim zbatohen praktikrat dhe metodologjitë e IPCC, të përditësuara.

Pyjet e vjetër në legjislacionin kombëtar dhe atë të huaj

Pyjet e vjetër janë një vlerë e jashtëzakonshme e natyrës. Ka disa përkufizime për to në legjislacionin e BE-së por edhe të vendeve të tjera. Edhe në Shqipëri, ka përkufizim në ligjin 57/2020. Në tabelën nr.1 jepet një vlerësim krahasues i legjislacionit kombëtar dhe atij të huaj për pyjet e vjetër.

Figura 5 Pyjet e vjetër në legjislacionin kombëtar dhe atë të huaj

Legjislacioni kombëtar			
Akti ligjor	Përkufizimi	Akti ligjor	Përkufizimi
Ligji 57/2020 Neni 3.52	“Pyll i virgjër” është pylli natyror i pacënuar nga veprimtaria njerëzore’	CBD ⁹	Një pyll parësor është një pyll që nuk është prerë kurrë dhe është zhvilluar në vijim të trazirave natyrore dhe nën procese natyrore, pavarësisht nga mosha e tij.
		Rregullorja (EU) 2018/841 ¹⁰ si dhe; Udhëzimet e KE për përcaktimin, hartëzimin, monitorimin dhe mbrojtjen e rreptë të pyjeve parësore dhe të vjetra të BE-së	Pyjet parësore dhe tokat e tjera pyjore, përkatësisht pyjet dhe tokat e tjera të pyllëzuara të specieve vendase, ku nuk ka indikacione qartësisht të dukshme të aktivitetit njerëzor dhe proceset ekologjike nuk janë të shqetësuara dukshëm.
		Agjencia Evropiane e Mjedisit ¹¹	Pyll i cili fillimisht mbulonte një rajon përpara ndryshimeve të shkaktuara nga njerëzit në mjedis.

Një numër akoma më i madh përkufizimesh që përdoren nga vende apo organizata të ndryshme jepen nga FAO¹².

Nga tabela nr.1 shihet që shumica e përkufizimeve ngjajnë me atë të bërë nga Konventa e Biodiversitetit (CBD).

⁹ <https://www.cbd.int/forest/definitions.shtml>

¹⁰ https://knowledge4policy.ec.europa.eu/glossary-item/primary-forest-0_en

¹¹ <https://www.eea.europa.eu/help/glossary/gemet-environmental-thesaurus/primary-forest>

¹² <https://www.fao.org/4/y4171e/y4171e36.htm>

1. Mbrojtja e pyjeve të vjetër në legjislacionin kombëtar. Mbrojtja e këtyre pyjeve parashikohet në VKM nr. Nr. 761, datë 9.12.2021 “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për krijimin e rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë (të paprerë), ruajtjen dhe trajtimin e pyjeve të virgjëra ose pothuajse të virgjëra, si dhe kalimin e tyre në konservim të plotë”. Në këtë VKM, aspektet e shpalljes dhe mbrojtjes së Pyjeve të Virgjëra ose pothuajse të virgjër parashikohet si vijon:

- i. Ruajtja dhe trajtimi i pyjeve të virgjër ose pothuajse të virgjër, të cilat janë të përcaktuara në planet e mbarështimit të ekonomive, grumbujve dhe drurëve pyjorë të veçantë, të cilësuar të virgjër ose pothuajse të virgjër, realizohet sipas kritereve të mëposhtme:
 - a) ruajtja e funksioneve ekologjike e mjedisore dhe evolucionit të tyre;
 - b) përmbushja e objektivave për mbarështimin e ekonomive, grumbujve dhe drurëve pyjorë të veçantë, të cilësuar të virgjër ose pothuajse të virgjër;
 - c) vendosja e masave objektive mbrojtëse për mbajtjen ose rivendosjen në një status të favorshëm ruajtjeje, për të siguruar mbrojtje afatgjatë të pyjeve të virgjër ose pothuajse të virgjër;
 - ç) përjashtimi nga shfrytëzimi dhe nga çdolloj ndërhyrje tjetër që çënon statusin e tyre;
 - d) përputhshmëria me planet e mbarështimit.
- ii. Ngastrat dhe nënngastrat në pyjet e virgjër ose pothuajse të virgjër, të identifikuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas informacionit të vendosur në dispozicion nga kadastra pyjore, kalojnë në konservim të plotë, bazuar në kriteret ndërkombëtare për konservimin e natyrës sipas IUCN (Unioni Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës), dhe trajtohen sipas rekomandimeve të planit të mbarështimit.

Për kalimin e pyjeve në konservim të plotë ndiqet procedura, si më poshtë vijon:

- a) njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet strukturave përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve, identifikojnë ngastrat dhe nën-ngastrat e pyjeve të virgjër ose pothuajse të virgjër që do të kalojnë në konservim të plotë;
- b) propozimi për kalimin në konservim të plotë të pyjeve të virgjër ose pothuajse të virgjër bëhet pas konsultimit me komunitetin e zonës pyjore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, shoqatat e përdoruesve të pyjeve, ekspertët e pyjeve dhe të biodiversitetit, akademikë të shkencave të natyrës dhe të pyjeve, si dhe pas miratimit nga këshilli bashkiak i njësisë së vetëqeverisjes vendore ku ndodhet zona pyjore;
- c) propozimi i njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas parashikimit të dhënë në shkronjën “a” të kësaj pike, dërgohet në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, e cila, pas verifikimit të përputhshmërisë së tij me Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor, brenda 2 (dy) muajve, i përcjell vlerësimin teknik strukturës përgjegjëse për pyjet në ministri;
- ç) struktura përgjegjëse për pyjet, pasi vlerëson që përcaktimi i ngastrave dhe nënngastrave, sipas shkronjës “a”, është në përputhje me programet dhe dokumentet strategjike për zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve, si dhe plotëson kërkesat e këtij vendimi, brenda 20 (njëzet) ditëve, ia përcjell për miratim ministrit propozimin për kalimin në konservim të plotë të pyjeve të virgjëra.

Problemi me pyjet e vjetër në Shqipëri, dhe veçanërisht me ato që gjenden jashtë rrjetit kombëtar të Zonave të Mbrojtura qëndron në faktin se nuk kanë plane menaxhimi të vlefshme aktualisht. Në Shqipëri ka edhe pyje të vjetër që kanë plane menaxhuese, por në ato plane mundet të mos jetë parashikuar mbrojtja strikte e pyjeve të vjetër. Kjo pasi ato plane janë hartuar përpara hyrjes në fuqi të VKM 761. Në shumicën e rasteve, për këto pyje, në planet e menaxhimit parashikohet – prerja (shfrytëzimi) e tyre.

Kjo bën të dosmosdoshme:

- Një inventar të plotë të pyjeve të vjetër në Shqipëri;
- Një manual për identifikim, shpalljen dhe menaxhimin e pyjeve të vjetër;
- Rishikimin e planeve të menaxhimit të pyjeve (në rastin kur ka pyje të vjetër) për të parashikuar në ato plane mbrojtjen strikte të tyre;
- Hartimin e planeve menaxhuese për ato pyje të vjetër që janë jashtë rrjetit të Zonave të Mbrojtura, në mënyrë që të garantohet sa më shpejt mbrojtja e tyre.

Nga ana tjetër, **ligji 87/2017 'Për Zonat e Mbrojtura'** (i ndryshuar), nuk ka një përkufizim të pyjeve të vjetër, apo ndonjë masë specifike menaxhuese a mbrojtëse për to. Në nenin 46 të këtij ligji përshkruhet se si menaxhohen pyjet në Zonat e Mbrojtura.

<p>Neni 46</p> <p>Pyjet, kullotat, ujërat dhe pasuritë e tjera natyrore brenda zonave të mbrojtura</p> <ol style="list-style-type: none">1. Pyjet në zonat e mbrojtura mjedisore përjashtohen nga klasifikimi si pyje prodhuese.2. Të gjitha ndërhyrjet e nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin e ekosistemeve të ndryshme realizohen vetëm në rast se janë parashikuar në planin e menaxhimit ose vijnë si pasojë e emergjencave natyrore, sipas projektit teknik dhe me miratim të AKZM-së.3. Ndërhyrjet e nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin kryhen nga banorët e zonave të mbrojtura, me qëllim përballimin e nevojave të tyre për ngrohje, në bazë të miratimit paraprak nga AdZM-ja të projektit teknik e të listës emërore të banorëve të zonës, të konfirmuar nga administratori i njësisë së qeverisjes vendore.4. Menaxhimi i pyllit dhe i pasurive pyjore, i ujërave e pasurive ujore, si dhe i pasurive të tjera, pronë publike dhe private, që ndodhen brenda një zone të mbrojtur, bëhen nga administrata e ruajtjes së zonës dhe në përputhje me planin e menaxhimit të zonës. Administrata i ushtron këto veprimtari drejtpërdrejt, nëpërmjet komunitetit lokal dhe/ose një subjekti të autorizuar prej saj.5. Kur këto pasuri janë pronë private, ato menaxhohen e përdoren nga pronari ose përdoruesi i ligjshëm vetëm në përputhje me planin e menaxhimit të zonës dhe me miratimin paraprak të administratës së ruajtjes së zonës.
--

Figura 6 Neni 46 i ligjit 87/2017 'Për Zonat e Mbrojtura'

Sipas këtij neni, nuk ka asgjë të parashikuar lidhur me pyjet e vjetër, se si duhen trajtuar, menaxhuar apo mbrojtur. Ndryshe nga sa janë praktikata e mira menaxhuese në këtë drejtim (si psh. lënia e një numri minimal për njësi sipërfaqe e drurëve të vjetër nëpër sipërfaqet pyjore, apo mbrojtja strikte e pyjeve të vjetër), ligji në fjalë nuk adreson asnjë element të tillë.

Një tjetër problem që vërehet në ligjin 87/2017 është edhe çështja që ka të bëjë me rigjenerimin natyror të pyjeve. Kështu, në nenet 48/g dhe 50/a të këtij ligji, ndër aktivitetet e ndaluara janë edhe "Mbjellja e pyjeve monokulture". Kjo përbën problem në rastin e mbështetjes së

rigjenerimit natyror të pyjeve, pasi nuk garantohet ky rigjenerim me speciet pyjore ekzistuese aty, duke humbur kështu natyralitetin e zonave pyjore. Kjo rezulton në ndërhyrje artificiale në suksesionin natyror të grumbujve pyjore.

2. Mbrojtja e pyjeve të virgjër në BE. Janë dy dokumente shumë të rëndësishme të BE-së që përfshijnë mbrojtjen e pyjeve të vjetra (primare). Këto janë ***Strategjia Evropiane e Pyjeve 2030*** dhe ***Strategjia e Biodiversitetit 2030***. Qëllimet dhe masat e propozuara në këto dokumente jepen në vijim:

a. Strategjia Evropiane e Pyjeve 2030. Në pikën 3.1 të këtij dokumenti “Mbrojtja e pyjeve të fundit parësore dhe të vjetra të mbetura të BE-së” thuhet se; *‘Ekziston ende një nevojë e menjëhershme për të përcaktuar pyjet parësore dhe të vjetra dhe për të vendosur regjimin e tyre të mbrojtjes, duke përfshirë përpjekjet e shtuara për të mbrojtur pyjet parësore në rajonet më të largëta dhe territoret jashtë BE-se, duke pasur parasysh vlerën e tyre jashtëzakonisht të lartë dhe unike të biodiversitetit. Për të ruajtur karakterin e paprekur të pyjeve të mbrojtura në mënyrë strikte, është thelbësore që dinamika e ciklit pyjor në këto pyje t’i lihet sa më shumë që të jetë e mundur proceseve natyrore, duke kufizuar aktivitetet nxjerrëse njerëzore, duke gjetur sinergji me ekoturizmin e qëndrueshëm dhe mundësitë rekreative’*. Po ashtu, më tej në këtë dokument kërkohet që shtetet anëtare duhet të angazhohen urgjentisht në përfundimin e hartës dhe monitorimit të këtyre pyjeve dhe të mos mundësojnë asnjë përkeqësim derisa të fillojnë të zbatojnë regjimin e mbrojtjes së tyre. Si rezultat i këtij dokumenti, në vitin 2023 KE ka nxjerrë Udhëzimin me nr. reference SWD(2023)62 datë 20.3.2023 “Për përcaktimin, hartëzimin, monitorimin dhe mbrojtjen e rreptë të pyjeve parësore dhe të vjetra të BE-së”¹³.

a. Strategjia e BE-së për biodiversitetin 2030. Në këtë dokument thuhet ...’ *Si pjesë e këtij fokusi në mbrojtjen e rreptë, do të jetë thelbësore të përcaktohen, të hartohen, të monitorohen dhe të mbrohen rreptësisht të gjitha pyjet parësore dhe të vjetra të mbetura të BE-së’*. Po ashtu, përveç mbrojtjes së rreptë të të gjitha pyjeve parësore dhe të vjetra të BE-së, BE-ja duhet të rrisë sasinë, cilësinë dhe qëndrueshmërinë e pyjeve të saj, veçanërisht kundër zjarreve, thatësirave, dëmtuesve, sëmundjeve dhe kërcënimeve të tjera që mund të rriten me ndryshimet klimatike.

13 [https://ec.europa.eu/transparency/documents-register/detail?ref=SWD\(2023\)62&lang=en](https://ec.europa.eu/transparency/documents-register/detail?ref=SWD(2023)62&lang=en)

Rregullorja 2024/1991 për restaurimin e natyrës

Rregullorja e BE-së 2024/1991, e njohur edhe si Ligji për Restaurimin e Natyrës, u miratua nga Këshilli Evropian në qershor 2024 dhe hyri në fuqi dy muaj më vonë. Kjo rregullore do t'u kërkojë të gjitha vendeve anëtare të BE-së të hartojnë dhe të fillojnë zbatimin e planeve kombëtare të restaurimit deri në korrik 2026.

Konteksti kryesor i rregullores 2024/1991 lidhur me lidhshmërinë pyjore:

1. Nr.63... Në mungesë të një metode të përbashkët për vlerësimin e gjendjes së ekosistemeve pyjore, që do të lejonte përcaktimin e objektivave specifike të restaurimit për ekosistemet pyjore, është e përshtatshme të vendoset një detyrim i përgjithshëm për përmirësimin e biodiversitetit në ekosistemet pyjore, dhe të masë përmbushjen e këtij detyrimi në bazë të indeksit të përbashkët të shpendëve të pyllit dhe të një përzgjedhjeje treguesish të tjerë, nga drurët e mbetur në këmbë, druri i shtrirë, pjesa e pyjeve me strukturë të pabarabartë, lidhjet pyjore, rezervat e karbonit organik, pjesa e pyjeve të dominuara nga speciet vendase të pemëve dhe diversiteti i llojeve të pemëve.
2. Neni 12 - Rivendosja e ekosistemeve pyjore. Shtetet anëtare do të arrijnë një tendencë në rritje në nivel kombëtar prej të paktën gjashtë nga shtatë treguesit e mëposhtëm për ekosistemet pyjore, siç specifikohet më tej në Aneksin VI, të zgjedhur në bazë të aftësisë së tyre për të demonstruar rritjen e biodiversitetit të ekosistemeve pyjore brenda shteti anëtar në fjalë. Trendi do të matet në periudhën nga 18 gushti 2024 deri më 31 dhjetor 2030, dhe çdo gjashtë vjet më pas, derisa të arrihen nivelet e kënaqshme të përcaktuara në përputhje me nenin 14(5):
 - a) drurë në këmbë;
 - b) druri i shtrirë;
 - c) pjesa e pyjeve me strukturë të pabarabartë;
 - d) lidhjet pyjore;
 - e) stoku i karbonit organik;
3. Neni 13 Mbjellja e tre miliardë pemëve shtesë. 13/2 Masat për arritjen e këtij angazhimi do të synojnë të rrisin lidhjen ekologjike dhe të bazohen në pyllëzimin e qëndrueshëm, ripyllëzimin dhe mbjelljen e pemëve dhe rritjen e hapësirës së gjelbër urbane.

Për momentin, Shqipëria nuk është anëtare e BE-së ndaj nuk ka detyrime për zbatimin e kësaj rregulloreje në këtë fazë. Gjithsesi, sa kohë që mbahet statusi i vendit kandidat për në BE, duhet filluar nga puna për përafrimin dhe përshtatjen edhe të kësaj rregulloreje.

Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se fragmentimi i habitateve pyjore në Shqipëri (nga zjarret, prerjet dhe aktivitetet minerare) është një problem madhor, do të ishte e këshillueshme që kjo rregullore të përshtatet më tej në legjislacionin kombëtar, veçanërisht pjesët e saj që lidhen me ekosistemet pyjore dhe pyjet e vjetra.

Rekomandime për përmirësime në legjislacionin pyjor shqiptar

Megjithëse legjislacioni pyjor shqiptar është i kompletuar thuajse me bazën ligjore sa i përket administrimit dhe menaxhimit të pyjeve, i mungojnë elementët bazë që garantojnë përdorimin e qëndrueshëm të tyre. Këta elementë gjenden pikërisht në rregulloret EUTR/EUDR dhe FLEGT.

Duke qenë të paformalizuar dhe të pacertifikuar, pyjet e Shqipërisë vazhdojnë të degradohen vit pas viti, duke u pakësuar ndjeshëm. Për të përmirësuar situatën rekomandojmë:

1. Përmes akteve ligjore të bëhet përfarimi i plotë me rregulloren EUTR dhe FLEGT. Më tej, duhen përcaktuar institucionet dhe autoritetet përkatëse për zbatimin e dy rregulloreve EUTR dhe FLEGT. Në këtë kuadër duhen vënë në funksion edhe: (i) 'Kujdesi i duhur' siç është përcaktuar në rregulloren EUTR ashtu në ligjin 57/2020; (ii) Certifikimi i cilësisë së produkteve, përfshirë prodhimet drusore dhe ato jodrusore nga pylli, (iii) sistemi i gjurmimit dhe monitorimit online, (iv) Komunikimi dhe informimi i operatorëve ekonomikë lidhur me procedurat e vlerësimit të rrezikut, (v) të hartohen dhe publikohen rregullat dhe procedurat e monitorimit dhe gjurmimit të produkteve të tyre.
2. Duhet nisur menjëherë puna për sistemin e certifikimit pyjor, dhe realizimin e tij.
3. Në këtë rast duhet inkurajuar puna e organizatave të shoqërisë civile në identifikimin dhe gjurmimin e lëndës drusore ilegale.
4. Duke qenë se pyjet e Shqipërisë nuk janë të certifikuar, të bëhet ndalimi i çdo lloj eksporti drejt vendeve të BE-së. Në këtë kontekst është e rëndësishme që autoritetet doganore të informohen për kushtet e rregulloreve FLEGT dhe EUTR. Të bëhen gati dhe përdoren në vijim formatet e 'Marrëveshjeve të partneritetit', siç përcaktohen në rregulloren FLEGT (neni 2.3).
5. Të përgatitet lista me produktet e drurit për të cilat zbatohet skema e licensimit FLEGT pavarësisht nga vendi partner, sipas kodimit përkatës që gjendet në aneksin e rregullores FLEGT. Po ashtu, lista e Lëndës drusore dhe produkte druri të klasifikuar në Nomenklaturën e Kombinuar të përcaktuar në Aneksin I të Rregullores së Këshillit (EEC) Nr 2658/87 (1), për të cilën zbatohet rregullorja EUTR.
6. Të bëhet trajnimi i stafëve përkatëse nga institucionet që do ngarkohen për të zbatuar rregulloret EUTR dhe FLEGT.
7. Paralelisht me përmbushjen e detyrimeve ndaj dy rregulloreve FLEGT dhe EUTR, qeveria duhet të përgatisë modalitetet për 'Certifikatën e origjinës' të çdo produkti drunor dhe jo-drunor që vjen nga pyjet.
8. Duhet bërë formalizimi i aktiviteteve në pyje, si elementi kryesor i qëndrueshmërisë së tyre, duke regjistruar dhe kontabilizuar çdo lloj produkti nga pyjet.

9. Duhet bërë përmirësime në legjislacionin kombëtar mbi mënyrat dhe modalitetet e mbrojtjes së pyjeve të vjetër, kudo ku ato gjenden. Në këtë rast, duhet përmirësuar si kuadri ligjor (VKM, udhëzime) ashtu dhe dokumentat teknike në fushën e pyjeve (psh. udhëzuesit për hartimin e planeve të menaxhimit të pyjeve dhe ai për Zonat e Mbrojtura).
10. Duke parë praktikën e deritanishme në vend, një kod i praktikave të mira menaxhuese në fushën e pyjeve do të ishte një mbështetje e madhe në këtë drejtim.
11. Duhet përmirësuar masat dhe praktikën parandaluese dhe ato menaxhuese të zjarreve në pyje, me fokus të veçantë tek pyjet e vjetër, të cilët janë më të rrezikuar në këtë drejtim.
12. Rritja e kapaciteteve të administratës pyjore dhe asaj të Zonave të Mbrojtura, për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshem të pyjeve, me fokus pyjet e vjetër.
13. Të hartohen, zbatohen dhe monitorohen kriteret dhe treguesit për menaxhimin e qëndrueshem të pyjeve, bazuar në praktikën me të mira evropiane.
14. Legjislacioni pyjor shqiptar të përfshijë terminologjinë teknike dhe juridike që gjendet në rregulloret përkatëse të BE-së (EUTR/EUDR, FLEGT, Restaurimi i natyrës dhe LULUCF).
15. Legjislacioni për pyjet dhe mbrojtjen e natyrës duhet të përshtatet për të mundësuar krijimin e një rrjeti ekologjik (të bazuar në pyjet e vjetra) për mishngrënësit e mëdhenj, si një mjet kyç për lidhjen e peizazheve pyjore në të gjithë vendin dhe në zonat ndërkufitare.
16. Bazuar në VKM Nr.761, datë 9.12.2021, AKP të përgatisë një udhëzues apo metodologji për identifikimin dhe kalimin në konservim të plotë të pyjeve të vjetër në Shqipëri. Kjo në përmbushje të mbrojtjes së vlerave ekologjike, sociale dhe ekonomike që pyjet e vjetra përfaqësojnë.
17. Legjislacioni kombëtar duhet të përshtatet me elementët e rregullores 2024/1991 për restaurimin e natyrës, të shoqëruar me planet përkatëse të veprimit.





Aneksi 1

Rregullore (BE) Nr. 995/2010 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e 20 tetorit 2010

RREGULLORE (BE) Nr. 995/2010 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE TË KËSHILLIT
e 20 tetorit 2010

duke përcaktuar detyrimet e operatorëve që vendosin lëndë druri dhe produkte druri në treg

Vendi:	Shqipëri	Data e plotësimit të tabelës:	21.11.2024
Personi që plotësoi Tabelën:	Abdulla Diku		
Nr total. i pikëve nëse transpozimi është i plotë:	26x5=130	Nr. total i pikëve për statusin aktual të transpozimit:	16

Tabela e përputhshmërisë; RREGULLORE (BE) Nr. 995/2010 E PARLAMENTIT DHE TË KËSHILLIT EVROPIAN
e datës 20 tetor 2010 dhe legjislacioni shqiptar për pyjet

<i>Neni nr.</i>	<i>Detyrimi i BE-së</i>	<i>Ligji kombëtar ekzistues (akti përkatës ë nr. i nenit)</i>	<i>Plotësiht në përputhje? (po/jo)</i>	<i>Nëse ka draft, jepni nr. e nenit që transponon detyrimin e BE-së</i>	<i>Statusi i transpozimit (5-0)</i>	<i>Shënime</i>
2	Përkufizimet Për qëllimet e kësaj rregulloreje, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme: “Dru dhe produkte druri” do të thotë druri dhe produktet e drurit të përcaktuara në Aneks, me përjashtim të produkteve të drurit ose përbërësve të këtyre produkteve të prodhuara nga druri ose produkte druri që kanë përfunduar ciklin e tyre jetësor dhe përndryshe do të hidheshin si mbetje, si përcaktuar në nenin 3(1) të Direktivës 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 19 nëntor 2008 mbi mbetjet	Ligji 57/2020 Neni 3	Po	3.11	5	Përkufizimi është plotësisht i përafëruar.
3	Statusi i drurit dhe produkteve të drurit të mbuluar nga FLEGT dhe CITES. Lënda e vendosur në produktet e drurit të listuara në anekset II dhe III të Rregullores (EC) Nr. 2173/2005, e cila është me origjinë nga vendet partnere të listuara në aneksin I të asaj rregulloreje dhe që përputhet me atë rregullore dhe dispozitat e saj zbatuese, do të konsiderohet se është shtytëzuar ligjërisht për qëllimet e kësaj rregulloreje. Lënda e specieve të listuara në Aneksin A, B ose C të Rregullores (EC) Nr 338/97 dhe që është në përputhje me atë Rregullore dhe dispozitat e saj zbatuese do të konsiderohet se është shtytëzuar ligjërisht për qëllimet e kësaj rregulloreje	Ligji 57/2020 Neni 28	Po	28.2	5	Përkufizimi është plotësisht i përafëruar.

Neni nr.	Detyrimi i BE-së	Ligji kombëtar ekzistues (akti përkatës E nr. i nenit)	Plotësisht në përputhje? (po/jo)	Nëse ka draft, jepni nr. e nenit që transponon detyrimin e BE-së	Statusi i transpozimit (5-0)	Shënime
4	<p>Obligimet e operatorëve</p> <p>1. Ndalohej vendosja në treg e lëndës drusore të prerë ilegalisht ose e produkteve të drurit që rrjedhin nga kjo lëndë.</p> <p>2. Operatorët duhet të ushtrojnë kujdesin e duhur kur vendosin lëndë druri ose produkte druri në treg. Për këtë qëllim, ata do të përdorin një kuadër procedurash dhe masash, në vijim të referuar si “sistem i kujdesit të duhur”, siç përcaktohet në Nenin 6.</p> <p>3. Çdo operator do të mbajë dhe vlerësojë rregullisht sistemin e kujdesit të duhur që përdor, me përjashtim të rasteve kur operatori përdor një sistem të kujdesit të duhur të krijuar nga një organizatë monitoruese e përmendur në Nenin 8. Sistemet ekzistuese të mbikëqyrjes sipas legjislacionit kombëtar dhe çdo mekanizëm zinxhir vullnetar i kujdestarisë që përmblush kërkesat e kësaj rregulloreje mund të përdoren si bazë për sistemin e kujdesit të duhur.</p>	Ligji 57/2020 Neni 28	Jo	28.1	1	Ky përkufizim është pjesërisht i qëndrueshëm pasi Neni 28.3 dhe 28.4 në Ligjin 57/2020 lë detyrimet për respektimin e FLEGT të realizohen nëpërmjet akteve nënligjore.
5	<p>Detyrimi i gjurmueshmërisë</p> <p>Tregtarët, përgjatë zinxhirit të furnizimit, do të jenë në gjendje të identifikojnë:</p> <p>a. operatorët ose tregtarët që kanë furnizuar me lëndë druri dhe produkte druri; dhe,</p> <p>b. sipas rastit, tregtarët të cilëve u kanë furnizuar lëndë druri dhe produkte druri.</p> <p>Tregtarët do të ruajnë informacionin e përmendur në paragrafin e parë për të paktën pesë vjet dhe do t'ia japin atë informacion autoriteteve kompetente nëse ato kërkojnë.</p>	Ligji 57/2020 Neni 27	Po	27.7	3	Ligji 57/2020 ka një përkufizim të ndryshëm; Lënda drusore transportohet me leje të lëshuar nga struktura përkatëse e shërbimit pëllor në bashki ose nga pronari privat i cili vërteton se prodhimi është në përputhje me ligjin. Leja e transportit përmban logjikisht furnizuesin/ët. Por ligji nuk e përmend kohën “pesë vjet”.

Neni nr.	Detyrimi i BE-së	Ligji kombëtar ekzistues (akti përkatës ë nr. i nenit)	Plotësisht në përputhje? (po/jo)	Nëse ka draft, jepni nr. e nenit që transponon detyrimin e BE-së	Statusi i transpozimit (5-0)	Shënime
6	<p>Sistemet e kujdesit të duhur</p> <p>1. Sistemi i kujdesit të duhur të referuar në Nenin 4(2) do të përmbajë elementët e mëposhtëm:</p> <p>a) masat dhe procedurat që ofrojnë akses në informacionin e mëposhtëm në lidhje me furnizimin e operatorit me lëndë druri ose produkte druri të vendosura në treg:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përshkrimin, duke përfshirë emrin tregtar dhe llojin e produktit, si dhe emrin e përbashkët të specieve të pemëve dhe, sipas rasisit, emrin e tij të plotë shkencor; - vendi i prerjes dhe aty ku është e aplikueshme: <ul style="list-style-type: none"> (i) rajoni nënkombëtar ku është prerë druri; dhe (ii) koncesioni i shfrytëzimit, - sasia (e shprehur në vëllim, peshë ose numër njësisish), - emri dhe adresa e furnizuesit për operatorin, - emrin dhe adresën e tregtarit të cilit i janë furnizuar lëndët drusore dhe produktet e drurit, - dokumente ose informacione të tjera që tregojnë përputhshmërinë e këtyre lëndëve drusore dhe produkteve të drurit me legjislacionin në fuqi; 	Ligji 57/2020 3 dhe 27	Jo	3.25 27.8	4	<p>Neni 3.25 i Ligjit 57/2020 ka përkufizimin për "Due diligence".</p> <p>Neni 27.8 Subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tregtisë së lëndës drusore dhe produkteve pyjore jodrusore zbatojnë sistemin e "kujdesit të duhur" ..</p> <p>Neni 27.8 ka përshkrim se si operatori duhet të kujdeset për 'kujdesin e duhur'. Por problemi është se ky sistem ende nuk është vendosur (duhet të bëhet nga Ligji)</p>
6	<p>b) procedurat e vlerësimit të rrezikut që i mundësojnë operatorit të analizojë dhe vlerësojë rrezikun e vendosjes në treg të lëndës drusore të prerë ilegalisht ose produkteve të drurit që rrjedhin nga kjo lëndë drusore.</p> <p>Procedura të tilla do të marrin parasysh informacionin e përcaktuar në pikën (a), si dhe kriteret përkatëse të vlerësimit të rrezikut, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - siguria e përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi, e cila mund të përfshijë certifikimin ose skema të tjera të verifikuara nga palët e treta, të cilat mbulojnë pajtueshmërinë me legjislacionin në fuqi; - prevalenca e prerjes së paligjshme të llojeve specifike të pemëve; 	n/a	Jo	n/a	0	Nuk është vendosur akoma.

<i>Neni nr.</i>	<i>Detyrimi i BE-së</i>	<i>Ligji kombëtar ekzistues (akti përkatës ë nr. i nenit)</i>	<i>Plotësisht në përputhje? (po/jo)</i>	<i>Nëse ka draft, jepni nr. e nenit që transponon detyrimin e BE-së</i>	<i>Statusi i transpozimit (5-0)</i>	<i>Shënime</i>
6	<ul style="list-style-type: none"> — mbizotërimi i prejtes së paligjshme ose praktikave në vendin e shfrytëzimit dhe/ose rajonin nënkombëtar ku është prerë lënda drusore, duke përfshirë parasysh përhapjen e konfliktit të armatosur; — Sanksionet e vendosura nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së ose Këshilli i Bashkimit Evropian për importet ose eksportet e lëndës drusore; — kompleksiteti i zinxhirit të furnizimit të lëndës drusore dhe produkteve të drurit. <p>c) me përjashtim të rasteve kur rreziku i identifikuar gjatë procedurave të vlerësimit të rrezikut të përmendur në pikën (b) është i papërfillshëm, procedurat e zbutjes së rrezikut që përbëhen nga një sërë masash dhe procedurash që janë të përshatshme dhe proporcionale për të minimizuar në mënyrë efektive atë rrezik dhe që mund të përfshijnë kërkim informacion ose dokumente shtesë dhe/ose kërkim verifikim nga palët e treta.</p>	n/a	Jo	n/a	0	Nuk është vendosur akoma.
6	2. Rregullat e detajuara të nevojshme për të siguruar zbatimin uniform të paragrafit 1, me përjashtim të kritereve të mëtejshme përkatëse të vlerësimit të rrezikut të përmendura në fjalinë e dytë të paragrafit 1 (b) të këtij neni, do të miratohen në përputhje me procedurën rregullatore të përmendur në Neni18(2). Këto rregulla do të miratohen deri më 3 qershor 2012.	n/a	Jo	n/a	0	Nuk është vendosur akoma.
6	3. Duke marrë parasysh zhvillimet e tregut dhe përvojën e fituar në zbatimin e kësaj rregulloreje, veçanërisht siç identifikohet nëpërmjet shkëmbimit të informacionit të përmendur në Nenin 13 dhe raportimit të përmendur në Nenin 20(3), Komisioni mund të miratojë akte të deleguara në përputhje me Nenin 290 TFEU për sa i përket kritereve të mëtejshme të vlerësimit të rrezikut që mund të jenë të nevojshme për të plotësuar ato të përmendura në fjalinë e dytë të paragrafit 1(b) të këtij Neni, me qëllim që të sigurohet efektiviteti i sistemi i kujdesit.	n/a	Jo	n/a	0	Nuk është vendosur akoma.

<i>Neni nr.</i>	<i>Detyrimi i BE-së</i>	<i>Ligji kombëtar ekzistues (akti përkatës ë nr. i nenit)</i>	<i>Plotësisht në përputhje? (po/jo)</i>	<i>Nëse ka draft, jepni nr. e nenit që transponon detyrimin e BE-së</i>	<i>Statusi i transpozimit (5-0)</i>	<i>Shënime</i>
6	<p>3. Duke marrë parasysh zhvillimet e tregut dhe përvojën e fituar në zbatimin e kësaj rregulloreje, veçanërisht siç identifikohet nëpërmjet shkëmbimit të informacionit të përmendur në Nenin 13 dhe raportimit të përmendur në Nenin 20(3), Komisioni mund të miratojë akte të deleguara në përputhje me Nenin 290 TFEU për sa i përket kritereve të mëtejshme të vlerësimit të rrezikut që mund të jenë të nevojshme për të plotësuar ato të përmendura në fjalinë e dytë të paragrafit 1(b) të këtij Neni, me qëllim që të sigurohet efektiviteti i sistemi i kujdesit.</p> <p>Për aktet e deleguara të përmendura në këtë paragraf do të zbatohen procedurat e përcaktuara në nenet 15, 16 dhe 17.</p>	Të mos vlerësohet	Jo	n/a	0	
7	<p>Autoritetet kompetente</p> <p>1. Çdo Shtet Anëtar cakton një ose më shumë autoritete kompetente përgjegjëse për zbatimin e kësaj rregulloreje.</p> <p>Shtetet Anëtare do të informojnë Komisionin për emrat dhe adresat e autoriteteve kompetente deri më 3 qershor 2011. Shtetet anëtare do të informojnë Komisionin për çdo ndryshim në emrat ose adresat e autoriteteve kompetente.</p> <p>2. Komisioni vë në dispozicion të publikut, duke përfshirë në internet, një listë të autoriteteve kompetente. Lista do të përditësohet rregullisht.</p>	Të mos vlerësohet	Jo	n/a	0	
8	<p>Organizatat monitoruese</p> <p>1. Një organizatë monitoruese duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të mbajë dhe të vlerësojë rregullisht një sistem të kujdesit të duhur siç përcaktohet në Nenin 6 dhe t'u japë operatorëve të drejtën për ta përdorur atë; - të verifikojë përdorimin e duhur të sistemit të tij të kujdesit të duhur nga operatorë të tillë; - të ndërmarrë veprimet e duhura në rast të dështimit nga një operator për të përdorur siç duhet sistemin e tij të kujdesit të duhur, duke përfshirë njoftimin e autoriteteve kompetente në rast të dështimit të konsiderueshëm ose të përsëritur nga operatori. 	n/a	Jo	n/a	0	Nuk është vendosur akoma.

<i>Neni nr.</i>	<i>Detyrimi i BE-së</i>	<i>Ligji kombëtar ekzistues (akti përkatës ë nr. i nenit)</i>	<i>Plotësisht në përputhje? (po/jo)</i>	<i>Nëse ka draft, jepni nr. e nenit që transponon detyrimin e BE-së</i>	<i>Statusi i transpozimit (5-0)</i>	<i>Shënime</i>
8	<p>2. Një organizatë mund të aplikojë për njohje si organizatë monitoruese nëse përmbush kërkesat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ka personalitet juridik dhe është themeluar ligjërisht brenda Unionit; - ka ekspertizën e duhur dhe kapacitetin për të ushtruar funksionet e përmendura në paragrafin 1; dhe - nuk ka ndonjë konflikt interesi në kryerjen e funksioneve të tij. <p>3. Komisioni, pas konsultimit me shtetet anëtare në fjalë, do të njohë si organizatë monitoruese një aplikant që plotëson kërkesat e përcaktuara në paragrafin 2;</p> <p>Vendimi për t'i dhënë njohje një organizate monitoruese do t'u komunikohet nga Komisioni autoriteteve kompetente të të gjitha Shteteve Anëtare;</p>	Të mos vlerësohet	Jo	n/a	0	
8	<p>4. Autoritetet kompetente kryejnë kontrollin në intervale të rregullta për të verifikuar që organizatat monitoruese që veprojnë brenda juridiksionit të autoriteteve kompetente vazhdojnë të përmbushin funksionet e përcaktuara në paragrafin 1 dhe të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në paragrafin 2. Kontrollin mund të bëhen gjithashtu kryhet kur autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar disponon informacionin përkatës, duke përfshirë shqetësimet e vërtetuara nga palët e treta ose kur ka zbuluar mangësi në zbatimin nga operatorët e duhur. Sistemi i kujdesit i krijuar nga një organizatë monitoruese. Një raport i kontrollleve do të vihet në dispozicion në përputhje me Direktivën 2003/4/KE;</p>	n/a	Jo	n/a	0	Nuk është vendosur akoma.
8	<p>5. Nëse një autoritet kompetent konstaton se një organizatë monitoruese ose nuk përmbush më funksionet e përcaktuara në paragrafin 1 ose nuk përmbush më kërkesat e përcaktuara në paragrafin 2, ai informon pa vonësë Komisionin;</p>	n/a	Jo	n/a	0	Nuk është vendosur akoma.
8	<p>6. Komisioni do të tërheqë njohjen e një organizate monitoruese kur, veçanërisht në bazë të informacionit të dhënë në përputhje me paragrafin 5, ka përcaktuar se organizata monitoruese nuk përmbush më funksionet e përcaktuara në paragrafin 1 ose kërkesat e përcaktuara në paragrafin 2. Përpara tërheqjes së njohjes së një organizate monitoruese, Komisioni informon Shtetet Anëtare të interesuara.</p>	Të mos vlerësohet	Jo	n/a	0	

<i>Neni nr.</i>	<i>Detyrimi i BE-së</i>	<i>Ligji kombëtar ekzistues (akti përkatës & nr. i nenet)</i>	<i>Plotësisht në përputhje? (po/jo)</i>	<i>Nëse ka draft, jepni nr. e nenet që transponon detyrimin e BE-së</i>	<i>Statusi i transpozimit (5-0)</i>	<i>Shënime</i>
